

Thirrje për Balerinë

Shkodër, 14/03/ 2019

Pozicioni: Balerinë për Teatrin Social
Titulli i projektit: Arti kundër dhunës
Afati përfundimtar i aplikimit: dt 23/03/2019
Periudha e angazhimit: Dhjetor 2018 – Maj 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Arti kundër dhunës” zbatohet në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Bashkia Shkodër, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit ReLOaD në Shqipëri, është bashkëfinancuese dhe bashkëzbatuese e programit, për projektet që po zbatohen në territorin e Bashkisë. Projekti “Arti kundër dhunës” përfshin aktivitete të ndryshme, të cilat materializohen në organizimin e mësimeve jo-formale argëtuese me të vegjël të qytetit (arte figurative dhe muzikë), si edhe me organizimin e një sërë aktiviteteve artistiko-sportive (koncerte, ekspozita, teatër, etj.) me të rinjtë dhe shtresat vulnerabël.

2. Qëllim i kontratës

Qëllimi i kontratës është përgatitja dhe vënia në skenë e 3 shfaqjeve *Dance Teatër* të cilat trajtojnë problematikën që hasen nga femrat që janë viktime të dhunës. Balerinët do të interpretojnë bazuar në koreografinë e realizuar nga koreografi bazuar në skenar. Në total do të përzgjidhen 2 (dy) balerinë. Shfaqjet do të vihen në skenë në qytetin e Shkodrës.

3. Detyrimet e Balerinëvve

Aktiviteti i balerinëve nis menjëherë pas nënshkimit të kontratës¹.

Ai është përgjegjës dhe angazhohet për të interpretuar në shfaqjen teatrale sipas orientimeve të dhëna nga koreografi. Balerinët duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm me koreografin dhe të respektojnë oraret e provave përcaktuar prej tij dhe ato të shfaqjeve përcaktuar nga OSHC “ARTE”. Shfaqjet teatrale do të vihen në skenë në qytetin e Shkodrës. Lidhur me çdo problematikë të mundshme, balerinët duhet të raportojnë tek koreografi i shfaqjes.

6. Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata nis menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe mbaron në 30 Maj 2019.

7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati


i. të detyrueshme

- a. Kandidati duhet të zotërojë diplomë Bachelor në Koreografi/Kërcim, ose të jetë duke ndjekur studimet në Koreografi/Kërcim.
- b. Te ketë eksperiencë të ngjashme në aktivitete artistike;
- c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë;
- d. Të jetë i aftë për punë.

ii. te preferueshme

Të jetë banor në Shkodër

¹ Kontrata do të jetë individuale për secilin prej balerinëve. Numri total i balerinëve të përzgjedhur do të jetë 2 (dy).



8. Dokumentacioni

- Letër motivuese;
- Jetëshkrimi (CV), ku të përfshihen eksperiencia e punës;
- Kopje e ID;
- Fotokopje e Diplomës (nëse ka);
- Vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore “i aftë për punë”;
- Vetëdeklarim gjendjen gjyqësore “i padënuar me vendim të formës së prerë”.

Kandidatët që shpallen fitues duhet të dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar nga kontraktuesi dokumentacioni si më poshtë:

- Vërtetim banimi;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Dëshmi e gjendjes shëndetësore.

9. Pagesa

Pagesa për Balerinin do të realizohet sipas kontratës që do të lidhet me Fondacionin Arte.

10. Aplikimi

Aplikimi duhet të dorëzohet **brenda dt. 23/04//2019**, me email në:

fondacioniarte@gmail.com

ose

me postë, në adresën zyrtare të Fondacionit ARTE
Rruga e Kavajës, Pallati 223, Shkalla 3, Kati 4, Apartamenti 23, Tiranë

Përgjigja e rezultateve jepet me email pas tri - pesë ditëve, që nga përfundimi i aplikimit. Kandidati duhet të paraqitet pranë Fondacionit ARTE për nënshkrimin e kontratës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.